

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, nga gjyqtarja Raima Elezi si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Vjollca Buzhala dhe Gjemil Elshani si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.Sh., D. Sh. dhe A.Sh.1, të gjithë nga fshati ..... Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale import, eksport, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuare e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.13/2015 të dt. 20.02.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësi i të akuzuarit A.Sh.1 av. Gj.S. nga ..... , **me datë 30.12.2016**, publikisht morri dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

1. **A.Sh.**, nga i ati P. dhe e ëma D. e lindur L., i lindur më datë “i lindur me ....” në Pejë, tani me banim në fshatin ..... Komuna e Klinës, i martuar – babë i 4 fëmijëve, me profesion kamerier, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i R së Kosovës, me nr. personal .....

2. **D.Sh.**, nga i ati P. dhe e ëma D. e lindur L., i lindur me datën “i lindur me ...” në fshatin ..... Komuna e Klinës, me vendbanim të përkohshëm në Norvegji, ..... .. , i martuar 4 fëmijëve , me profesion instalues i ujit, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i R. së Kosovës, me nr. personal .....

3. **A.Sh.**, nga i ati P. dhe e ëma D. e lindur L., i lindur me datën “i lindur me ...” në fshatin ..... Komuna e Klinës, me vendbanim të përkohshëm në Norvegji, ..... .. , i divorcuar , babai i 3 vëmijëve, me profesioni instalues i ujit, i gjendje së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i R. së Kosovë me nr. personal .....

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.1. të KPP-së.

## LIROHEN NGA AKUZA

Se me datë 13.01.2015 rreth orës 20:30 minuta në pikën kufitare të Vërmicës, në hyrje nga Shqipëria për në Kosovë në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armë transportojnë më shumë se katër materie plasëse apo më shumë se 400 pjesë të municionit në atë mënyrë që gjatë kontrollimit të automjetit të udhëtarëve “.....” me tabela të Kosovës ..-...- .. të cilin e drejtonte i akuzuari A.Sh. dhe pas një kontrolli rutinorë të automjetit nga ana e Policisë kufitare në bashkëpunim me zyrtar doganor tek ulësja e parë dhe e pasme të automjetit janë gjetur pjesë e municionit –saçme të fishekëve të gjuetisë “3 (tre) shishe plastike” me peshë 19 kg e 820 gr, gëzhoja të fishek të gjuetisë “6 (gjashtë) qese plastike” 600 copë, sqepat e fishekëve të gjuetisë “9 (nëntë) qese plastike “900 copë, kapsollat e fishekëve të gjuetisë 5 pako, kapak të fishekëve të

gjuetisë “9 (nëntë) qese plastikës “900 copë, makinë të dorës për mbushjen e gëzhjojave të fishekëve të gjuetisë 2 copë.

-Me këtë do të kishin kryer veprën penale importi, eksport, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Prej të akuzuarve A.Sh., D.Sh. dhe A.Sh.1 , konfiskohen saqmet të fishekëve të gjuetisë (tri shishe) 19 kg e 820gr, gëzhjojat e fishekëve të gjuetisë (6 qese) 600 copë, shqepa të fishekëve të gjuetisë ( 9 qese) 900 copë, kapsolla të fishekëve të gjuetisë (5 pako) 500 copë , kapakë të gëzhjojave (9 qese) 900 copë, (2 copë) makina të dorës për mbushjen e gëzhjojave, në interes të përgjithshëm.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.nr.13/15 të datës 20.02.2015 kundër të akuzuarve A.Sh., D. Sh. dhe A.Sh.1 të gjithë nga fshati ..... Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale importi, eksport, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP-së. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndronë në tërësi pranë aktakuzës pasi që nga tërë rrjedhja e shqyrtimit kryesor në këtë çështje penale, nga provat material të administruara, deklaratat e ekspertit të balistikës ing. H.K. dhe eksperti për armë nga AKF-ja të cilit në mënyrë detaje dhe të çartë kanë sqaruar lidhur me faktin se sasia prej 19.820 kgr të saqmave për fishekë të gjuetisë janë materie plasëse e padyshimtë edhe nga deklaratat e mbrojtësve të akuzuarit se të njëjtën sasi e kanë transportuar nga R. e Shqipërisë pa leje dhe autorizim Organit kompetent konsideron se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar gjendja faktike në këtë çështje penale, këtë duke e referuar edhe vërejtjeve të dhënë nga gjykata e Apelit dhe se në bazë të këtyre provave janë formuar dhe qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale dhe se me këto veprime të akuzuarit kanë kryere veprën penale për të cilën akuzohen. Andaj precizon që pas vlerësimit të të gjitha provave të njëjtë të shpallen fajtorë dhe të iu shqiptohet dënimi i paraparë me ligj, me propozim që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë të dënimit gjykata të merr parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

Mbrojtësi I të akuzuarit A.Sh. av. Gj.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron se aktakuza e prokurorisë të Shtetit në tërësi është e pabazuar sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për veprën penale të sanksionuar me nenin 372 KP-së , sepse sin ë procedurën e provave ashtu edhe me mendimin e ekspertëve të lamiisë përkatës është vërtetuar në mënyrë mjaftë bindëse se nuk është fjala për armë e as për materie plasëse. Në rastin konkret mund të bëhet fjalë për një kundërvajtje doganore e cila ka rrethana të veta lehtësues sepse të akuzuarit i kanë paraqitur vetë materialin e blerë në shitoren e specializuar siç është përmendur dhe se vlera e blerjes sipas faturës ka qenë 166 € e pjesëtuar për tre të akuzuar çka do të thotë çdo njëri ka transportuar mallë në vlerë prej 55 € e 33 cent. Gjithë kësaj shtohet edhe fakti se të tre të akuzuarit janë anëtarët Shoqatës gjyetares dhe gjyetares të pasionuar me leje valide të armëve dhe se blerja e këtij materiali është bërë në lajëthim duke menduar se nuk janë duke shkelur asnjë normë ligjore dhe se të akuzuarit materialin në fjalë mund të blejnë në shitoret e specializuar në

Prizren, Pejë, apo në Prishtinë. Konsideron që në veprimet e të mbrojturit të tij dhe bashkëekzekutorëve nuk ekzistojnë elementet e veprës penale prandaj propozon që që njejt të lirohen nga akuza. Në rastin eventual nëse gjykata gjen se në veprimet e tyre ekzistojnë elementet e veprës penale i propozon gjykatës që të merr parasyshtë rrethanat lehtësuese se kur njëherë i mbrojturi i tij e asë të tjerë nuk janë përgjigjur për asnjë vepër penale, sjellja korrekt në raport me gjykatën me propozim që gjykata të liron nga akuza me propozim që materialin e konfiskuar të ia kthenë në shfrytëzim dhe posedim të lirë.

I akuzuari A.Sh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij , mbetet pranë fjalës së mëhershëm se nuk e ndijën veten fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet pasi që nuk ka ditur se ka qenë e ndaluar një gjë e tillë, se është hera e parë që ka blerë sendet e gjuetisë jashtë Kosovës sepse gjithmonë kanë blerë në Kosovë .

I akuzuari D.Sh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë fjalës së dhënë më herët se nuk e ndijën veten fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet pasi që nuk ka ditur se ka qenë e ndaluar një gjë e tillë, se është hera e parë që ka blerë sendet e gjuetisë jashtë Kosovës sepse gjithmonë kanë blerë në Kosovë .

I akuzuari A.Sh.1 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë fjalës së dhënë më herët se nuk e ndijën veten fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet pasi që nuk ka ditur se ka qenë e ndaluar një gjë e tillë, se është hera e parë që ka blerë sendet e gjuetisë jashtë Kosovës sepse gjithmonë kanë blerë në Kosovë .

I akuzuari A.Sh. në mbrojtjen e vet duke mohuar të dhënat nga aktakuza ka deklaruar se me date 13.01.2015 diku rreth orës 10:00 të mëngjesit së bashku me vëllezërit D. dhe A.Sh.1 janë nisur për në Shqipëri me automjetin e tij , kanë shkuar në qytetin e Lezhës dhe pasi kanë ngrënë bukën meqenëse janë anëtarë të shoqatës së gjuetarëve të Klinës kanë shkuar në një shitore e cila është e licencuar për armë të gjuetisë, fishekëve, materieve plasëse dhe gëzhjojave dhe duke ditur se nuk po e shkelin ligjin dhe kanë të drejtë me ble këto materie, gëzhjoja, saçme dhe sqepa, e poashtu janë informuar edhe nga shitësi se nuk ka kurrfarë ndalesë ligjore për këto sende përveç se është e ndaluar blerja e barutit ,kanë vendosur dhe kanë blerë sendet e përmendura në aktakuzës . Për këto sendet kanë paguar 166 € , kanë vendosur në automjet në ulësen e prapme dhe një qese në ulësen e përparme mirëpo me të arritur në kufi pas një kontrole rutinore nga patrulla e policisë kufitare, në bashkëveprim e doganës, në pyetjen e tyre e kanë diç për të paraqitur kanë paraqitur të gjitha sendet e blera duke thanë se kanë gëzhjoja të zbrazta dhe se materialin e kanë blerë në Lezhë për nevojat e veta dhe ata i kanë treguar se duhen të konfiskohen sepse nuk mund të bëhet transporti në territorin e Kosovës pasi që me Ligjin në fuqi është i ndaluar, për të cilën fakt ata nuk kanë ditur. Edhe pse në shitore ka pas barut nuk kanë blerë sepse kanë ditur se është e ndaluar dhe kjo ka qenë hera e parë që kanë blerë jashtë Kosovës.

I akuzuari D.Sh. në deklaratën e vet nuk ka kontestuar faktin se me vëllezërit A.Sh. dhe A.Sh.1 kanë qenë në Shqipëri dhe kanë blerë materialet e përmendura në aktakuzë duke shtuar se fatura për blerje ka qenë në emër të tij, A.Sh. ka qenë vozitësi i automjetit dhe gjatë kontrollit rutinorë ka paraqitur sendet të blera, nuk kanë poseduar autorizim për blerjen e sendeve .

I akuzuari A.Sh. në deklaratën e vet nuk ka kundërshtuar faktin se nuk ka ditur që duhet autorizim për blerjen dhe transportimin e sendeve të përmendura në aktakuzë pasi që jeton

në Norvegji ku blerja e këtyre sendeve është e lejueshme përpos barutit dhe se për këtë arsye nuk kanë blerë barutin edhe pse në shitore ku janë furnizuar ka pasur barut. Përndryshe në Shqipëri kanë shkuar në vizitë tek daja dhe duke drekuar në një restorant “Pallma” kanë vërejtur një shitore e specializuar për gjueti, të tretë janë gjuetarë prandaj kanë hyrë në shitore dhe kanë vërejtur se çmimet janë më të ulëta se në Kosovë dhe kanë vendosur të blejnë.

Gjykata ka administruar provat e propozuara me dëgjimin e ekspertëve L.R. specialist i lartë i armëve të zjarrit – fusha balistike dhe ing. H.K. dhe shikimi në tre shishe plastike me saçma të fishekëve të gjuetisë, në peshë prej 19.802 kg, në 6 qese gëzhoja të fishekëve të gjuetisë (600 copë) , 9 qese shqepa të fishekëve të gjuetisë (900 copë), 5 pako kapsula për fishek të gjuetisë (500 copë), 9 qese kapsula të gëzhojave (900 copë) , dhe dy makina të dorës për mbushjen e gëzhojave.

Pas vlerësimit të provave gjykata ka gjetur se vepra për të cilën janë të akuzuar të akuzuarit, sipas ligjit nuk paraqet vepër penale. Kjo sepse për të ekzistuar çfardo vepër penale duhet të jenë të realizuara elementet esenciale të përshkrimit ligjor të veprës penale. Pa realizimin e të gjithë elementeve qenësore të ndonjë vepre penale nuk ka as realizim të elementit të përgjithshëm të parapar me ligj, do të thotë se nuk ka vepër penale nëse ndonjë gjendje faktike nuk mund të jetë e përfshirë në përshkrimin ligjor të ndonjë vepre penale.

Në rastin konkret gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së Apelit ka dëgjuar ekspertin L.R., specialisti i lartë i armëve të zjarrit, fusha balistike pranë Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme i cili në mesë tjerash ka sqaruar se dëshmit që janë objekti i akuzës janë pjesë të fishekëve – municionit i pushkës së gjuetisë dhe poqëse këto bashkohen nuk mund të vihet deri te ndonjë shkrepje e këtilli lloji të fishekëve sepse mungon elementi kryesor baruti çka do të thotë se pas goditjes së kapsulës ndezëse bëhet djegja e barutit dhe e lënë në lëvizje saqmën . Poashtu ka deklaruar se pjesë e municionit të cilat janë objekt e kësaj çështje penale pa barutin nuk janë mjete plasëse. Në përputhje me këtë ka dëshmuar edhe eksperti ing. H.K. i cili në mesë tjerash ka sqaruar se materiali i cili është objekt i aktakuzës konsiderohet si pjesë përbërëse të fishekut – municionit e jo fishek komplet sepse mungon pjesa kryesor baruti i cili si i tillë nuk mund të aktivizohet. Sa i përket kapsullit e njëjta është përbër prej një materie që quhet azit lëgjur e cila kur ngacmohet me gjilpërën goditëse ai liron thermia të cilat e ndezin barutin në fishekë dhe ai liron një energji dhe teperatur të madhe dhe i hedhe sverat nga gëzhoja me një shpejtësi prej 340m/s. Kapsulli nuk paraqet mjetë të rrezikshëm shpërthyes , ka krismën kur ndezët më të vogël se sa fishekë zjarret (petardat), si i tillë nuk mund të aktivizohet vet por me trusje permanente ose me hedhjen në zjarë ndezët sikurse fishekë zjarret por nuk mundet të aktivizohet pa ndonjë presione – shtypje apo çfardo metoda tjera .

Duke vlerësuar të gjitha rrethana të përmendura e duke patur parasysh edhe faktin jokontestues se materjet, objekti i aktakuzës nuk mund të përfshihet në përshkrimin faktik të veprës penale e cila i vëhet në barrë të akuzuarve , gjykata nuk ka fituar bindjen se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar prandaj, pranë gjendjes së këtille të çështjes të akuzuarit i ka liruar nga akuza në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 454 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 69 të KP-së

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELOR NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.235/15 të dt.30.12.2016**

**Sekretarja juridike**  
**Valdete Zurnaxhiu**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Raima Elezi**

**UDHËZIM JURIDIKË:** kundër këtij aktgjykimi palët kanë drejtë të ushtrojnë ankesë në afatin prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamentit për Krime të Rënda në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

**Përkthyesi gjyqësore**  
**Asnije Berisha.**